



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 173/2023

Datë: 28/08/2023

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 370 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118 dhe Ligjin nr. 08/L-102, në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat, në këtë përbërje:
 - 1.1. Znj. Manushe Karaqi, kryesuese; z. Agron Hoxha, zv. kryesues;
 - 1.2. Z. Adnan Konushevc, anëtar; z. Hajrullah Aruqi, zv. anëtar; dhe
 - 1.3. Z. Rushit Hoxha, anëtar; z. Besnik Aliu, zv. anëtar.
2. Mandati i të emëruarve nga pika 1 e këtij vendimi zgjatë dy (2) vjet, me mundësi të ri-emërimit.
3. Obligohet Komisioni Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat për zhvillimin e procedurës disiplinore në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi për përmbartimin privat.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albulena HAXHIU
Ministria e Drejtësisë

Vendimi i'u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit Disiplinor;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretares së Përgjithshme/MD;*
- *Departamentit për Profesione të Lira/MD; dhe*
- *Arkivot të Ministrisë së Drejtësisë.*